



A.nr.377/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.377/2026, të datës 30.03.2026 të parashtruar nga ankuesi A.R, të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat Hajzer Salihu, kundër organit të punësimit/Agjencia Pyjore e Kosovës, në çështjen juridike-administrative “*transferim/ristrukturimit*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 18.08.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet** si e pabazuar ankesa me numër A.nr.377/2026, e datës 30.03.2026, e parashtruar nga ankuesi A.R.
- II. Mbetet në fuqi** Vendimi Nr.R. APK 6/2026, i datës 27.02.2026, i u.d. Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministrisë së Digjitalizimit dhe Administratës Publike.

A r s y e t i m

Ankuesi A.R (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), më datë 30.03.2026, përmes përfaqësuesit të tij, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.R.APK 6/2026, të datës 27.02.2026, të u.d Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministrisë së Digjitalizimit dhe Administratës Publike, për shkak të shkeljeve ligjore dhe procedurale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Pyjore të Kosovës, ndërsa, kjo e fundit ka përcjell përgjigje në pretendimet ankimore të ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr. protokolli 1594/2026 të datës 30.03.2026 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje në kërkesë e datës 23.03.2026 nga Menaxherja e Personelit APK për ankuesin; Emailin e datës 14.01.2026 nga V.D për Z.K; Listën për Specialist; Emailin e datës 03.03.2026 nga D.G për ankuesin; Vendimin Nr.R. APK 6/2026, të datës 27.02.2026; Lista e zyrtareve që janë caktuar Specialist; Emailin e datës 12.06.2024 nga Q.B për D.G; Emailin e datës 12.06.2024, 07.05.2024 dhe

19.04.2024 nga D.G për A.F; Vendimin Ref. DE-303/25 të datës 16.07.2025; Vendimin Ref:DE-644/24 të datës 05.08.2024; Akt Emërimit të datës 18.03.2024 të ankuesit; Emailin e datës 27.02.2026 nga SIMBNJ për ankuesin; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 27.02.2026, 26.02.2025, 29.02.2024 për ankuesin; Vendimin Ref:KE-87/23 të datës 07.02.2023; Vendimin Ref: KE-392/23 të datës 07.07.2023; Diplomën e datës 06.09.2021; Listën e rezultateve të studimeve datës 15.12.2021, Diplomën e datës 12.01.2023; Listën e rezultateve të studimeve 05.12.2023; Autorizimin e datës 19.02.2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 02.04.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 09.04.2026; Formularin e përshkrimit të punës i datës 31.10.2025 për pozitën Zyrtar i Lartë për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve; Raportin e punës të Komisionit të Ristrukturimit i datës 02.02.2026; Vendimin e datës 05.11.2025 për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit në APK; Emailin e datës 31.10.2025 për miratimin e përshkrimit të detyrave të punës në APK; Listën e pagave për ankuesin shkurt dhe janar 2026, dhjetor 2025.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, **sepse**:

I. Gjendja e çështjes

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se:

- Ankuesi sipas Akt Emërimit SBNJD-131/2024 të datës 18.03.2024, mbante pozitën *Zyrtar për Monitorim dhe Mbrojtje të Pyjeve*, në Drejtoratin Koordinues Rajonal në Prishtinë në kuadër të Agjencisë Pyjore të Kosovës, më klasë profesional 2.
- Në bazë të Vendimit Nr.227/ 2025, të datës 05.03.2025, të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, është miratuar Rregulloren (ZKM) Nr. 02/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Pyjore të Kosovës.
- Drejtori i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me Vendimin me numër protokolli 2109, të datës 05.11.2025, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për Agjencinë Pyjore të Kosovës.
- Komisioni i Ristrukturimit për Agjencinë Pyjore të Kosovës, më datë 02.02.2026, ka miratuar Raportin përfundimtar me numër protokolli 94 lidhur me procesin e ristrukturimit në Agjencinë Pyjore të Kosovës, rrjedhimisht, ankuesi nga pozita e mëparshme *Zyrtar për Monitorim dhe Mbrojtje të Pyjeve*, është propozuar të transferohet në pozitën *Zyrtar i Lartë për Mbrojtjes dhe Ruajtjen e Pyjeve*, në Divizionin për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve në Departamentin Rajonal në Prishtinë në kuadër të Agjencisë Pyjore të Kosovës.
- U.d Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me Vendimin Nr.R. APK 6/2026, të datës 27.02.2026, ka transferuar ankuesin nga pozitën *Zyrtar për Monitorim dhe Mbrojtje të Pyjeve* në pozitën *Zyrtar i Lartë për Mbrojtje dhe Ruajtjen e Pyjeve*.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton Vendimin Nr.R. APK 6/2026 të datës 27.02.2026, duke pretenduar se vendimi për transferimin e ankuesit është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore ngase është dashur të transferohet në kategorinë Specialist meqë plotëson kushtet për specialist këtë e mbështet edhe në arsyet se DMZP ka pranuar sistemimin e disa zyrtarëve në kategorisë Specialist, ndërsa, në rastin konkret të ankuesit kemi të bëjmë me diskriminim. Kërkon që të aprovohet ankesa, të anulohet vendimi i kontestuar, të obligohet DMZP që ankuesin ta sistemoj në kategorinë Specialist dhe të paguaj pagën në mënyrë retroaktive në mes klasës

profesional 1 me koeficient 5.7 dhe kategorisë së specialist e koeficient 7 dhe atë nga data 14.01.2026 deri në zbatimin e këtij vendimi.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me të drejtën e tij të sistemimit për shkak të riorganizimit, Kolegji i Këshillit iu referua dispozitave të nenit 66 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion; 2.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi/i; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet komisioni i ristrukturimit që shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi/i civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit/it në një pozitë të lirë, për të cilën i plotëson kërkesat e vendit të punës. 4. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia përgjegjëse në bazë të propozimit të komisionit. 5. Nëpunësi/i mund të refuzojë transferimin vetëm për arsye të parashikuara në paragrafin 3. të nenit 63 të këtij ligji. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera, përbën shkak për lirimin nga shërbimi civil. 6. Komisioni i ristrukturimit, i parashikuar në paragrafin 3. të këtij neni, drejtohet nga njësia përgjegjëse dhe në të bëjnë pjesë përfaqësues të institucioneve të parashikuara në nën-paragrafët 2.1., 2.2., 2.3. apo 2.4. të këtij neni, sipas rastit ku bëhet ristrukturimi përkatës..... dhe si rrjedhojë bazuar në frymën e këtyre normave juridike, Kolegji i Këshillit vlerëson së ristrukturimi është proces i ndryshimit të organizmit të institucionit si rezultat i ndryshimit të misionit dhe fushëveprimit të institucionit, bashkimit apo fuzionimit të dy apo me shumë institucioneve, shuarjes së institucionit-eve apo shuarjes së funksioneve të caktuara të institucionit përkatës, dhe rrjedhimisht si rezultat i riorganizimit të institucionit mund të ketë ndryshime të vendeve të punës, shkurtime (shuarje) të vendeve të punës apo ndryshime të kriterëve të vendeve të punës.*

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në Rregulloren (ZKM) Nr. 02/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Pyjore të Kosovës, ka gjetur se pozita e ankuesit sipas akt emërimit të datës 18.03.2024, *Zyrtar për Monitorim dhe Mbrojtje të Pyjeve*, në Drejtoratin Koordinues Rajonal në Prishtinë, nuk është paraparë me këtë rregullore dhe për rrjedhojë në kuadër të Departamentit Regjional në Prishtinë janë paraparë tri divizione: *Divizioni për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve; Divizioni për Produktet Drunore, Jo drunore dhe Funksionet tjera të Pyllit dhe Divizioni për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime*, ndërsa, sipas raportit të Komisionit të Ristrukturimit ankuesi është propozuar të sistemohet në Departamentin e njëjtë pra atë Regjional në Prishtinë dhe në pozitën *Zyrtar i Lartë për Mbrojtje dhe Ruajtjen e Pyjeve*, në Divizionin për Mbrojtjen dhe Ruajtje të Pyjeve, e cila pozitë sipas Rregullores (ZKM) Nr. 02/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Pyjore të Kosovës, është kategorizuar në kategorinë profesionale, klasa profesional 1.

Gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, i cili pretendon se është dashur që të sistemohet në kategorinë Specialist, Kolegji i Këshillit, ju referuar Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përkatësish nenit 8: *Kategoria e specialistëve është kategoria përgjegjëse për kryerjen e detyrave të veçanta profesionale që kërkojnë përgatitje specifike sipas fushave të përcaktuara në Shtojcën Nr. 1 të kësaj Rregulloreje, (më Shtojcën Nr.1/4 të kësaj rregulloreje tek përshkrimi*

për klasën e specialistëve është përcaktuara: “Në këtë klasë vendosen pozitat e nivelit të lartë profesional me përgatitje specifike, të cilat kryejnë detyra që kërkojnë njohuri të thella profesionale. Mbajtësit e këtyre pozitave kryejnë një sërë detyrash të natyrës komplekse ose specifike në mënyrë individuale ose si udhëheqës ose anëtar i një ekipi. Mbajtësit e këtyre pozitave punojnë të pavarur dhe pa mbikëqyrje dhe mbështetje profesionale brenda udhëzimeve të përgjithshme lidhur me objektivat dhe afatet e përfundimit të detyrave”, kurse si kushte formale për këtë kategori janë paraparë: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në fushat e inxhinierisë, planifikim hapësinor, arkitekturë, urbanizëm, gjeodezi, kimi, fizikë, matematikë, biologji, mjekësi, farmaci, biokimi, ekologji, pylltari, bujqësi, veterinar, gjeografi, ambient, astronomi, astrofizikë, pa përfshirë drejtime arsimore dhe nenit 27 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet: 1. Klasa të cilës i përket secila pozitë konkrete e kategorisë së specialistëve dhe profesionale, përcaktohet dhe miratohet njëkohësisht me Rregulloren për Organizim të Brendshëm të Institucionit. 2. Miratimi përfundimtar i klasifikimit të vendeve të punës ndjek procedurën për propozimin dhe miratimin e Rregullores së Organizimit të Brendshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Andaj, referuar bazës ligjor si me sipër, Kolegji i Këshillit konstaton së pretendimi ankimor mbi këtë bazë nuk gjen mbështetje sepse pozita në të cilën është transferuar ankuesi *Zyrtar i Lartë për Mbrojtje dhe Ruajtjen e Pyjeve*, në Divizionin për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve, nuk është paraparë si pozitë e kategorisë së Specialistit sipas Rregullores (ZKM) Nr. 02/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Pyjore të Kosovës, por është paraparë vetëm si kategori profesionale. Rrjedhimisht, pretendimi i ankuesit se më datë 14.01.2026, Zyrtarja e Lartë e Personelit ka përcjell listën e zyrtarëve të APK për kategorizim në pozitën Specialist përfshirë edhe ankuesin, Kolegji i Këshillit nga shkresat e lëndës ka gjetur se ky email ishte dërguar në fazën kur komisioni i ristrukturimit ka qenë në procesin e punës dhe sipas kësaj emaili pozita e ankuesit sipas kësaj liste është shënuar *Zyrtar për Monitorim dhe Mbrojtje të Pyjeve* e cila pozitë siç u konstatua më sipër nuk është paraparë sipas Rregullores (ZKM) Nr. 02/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Pyjore të Kosovës.

Marr parasysh që sipas Rregullores (ZKM) Nr. 02/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Pyjore të Kosovës, pozita ku është transferuar ankuesi *Zyrtar i Lartë për Mbrojtje dhe Ruajtjen e Pyjeve* është kategorizuar në kategorisë profesionale, atëherë Kolegji i Këshillit, vlerëson se në këtë fazë të procedurës nuk kemi diskriminim ndaj ankuesit në raport me sistemimin e zyrtarëve të tjerë të përmendur në ankesë për faktin që i njëjti i referohet rasteve në Departamentin Regjional në Ferizaj, Pejë, Prizren dhe Gjiilan, ku zyrtarët në fjalë janë transferuar në pozitat *Zyrtar i lartë për Pylltari* e cila pozitë sipas Rregullores (ZKM) Nr. 02/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Pyjore të Kosovës është paraparë si pozitë në kuadër të kategorisë Specialist, andaj, Kolegji nuk gjen rrethana të diskriminimit të ankuesit.

Kolegji i Këshillit mbi bazën e konstatimeve si më lartë, vlerëson së Komisioni i Ristrukturimit në rastin e propozimin për sistemim të ankuesit ka vepruar në pajtim me 66 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenet 13, 14 dhe 15 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, dhe se Vendimi Nr. R. APK 6/2026, i datës 27.02.2026, i u.d Drejtorit të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, është nxjerr në pajtim me nenin 66 paragrafi 4 Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenin 14 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë dhe po ashtu akti kontestuar është në pajtim me nenin 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme

Administrative, arsyetimi është dhënë në kuptim të raportit të komisionit të ristrukturimit, kështu që, pretendimet ankimore të ankuesit janë tërësisht të pabazuara.

Thënë si më lartë, e duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në diapozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë-Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.377/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit, Avokat Hajzer Salihu;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Digjitalizimit dhe Administratës Publike;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në APK; dh
- Arkivit të KPMSHCK-së.